



Protokoli i shkurtë i mbledhjes së Kuvendit të dytë të rregullt të BISHZ-së më 11.12.1999

Vendi: Hotel Löwen, Bernstrasse 28, 3110 Münsingen
Data: E shtunë, 11 dhjetor 1999 / 14.00 - 17.00
Protokoli: Ahmet Xhigoli (kryetar)
Pjesëmarrës: Ca. 40

Pikat e rendit të ditës:

1. Përshëndetja e të pranishmëve - hapja e Kuvendit
 2. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 05.12.1998 - 10.12.1999
 3. Zgjedhja e kryesisë së re sipas nenit 7.c. të Statutit
Zgjedhja e komisionit të kontroll-revizionit sipas nenit 7.d. të Statutit
 4. Të ndryshme
-

1. Përshëndetja e të pranishmëve - hapja e Kuvendit

Dr. Ahmet Xhigoli i përshëndeti të gjithë të pranishmit si dhe në veçanti musafirët e fëtuar zonjën Jolanda Parrucaj (Sekretare e parë e Ambasadës shqiptare në Bernë) dhe zotëri Halim Hyda (Sekretar i parë i Ambasadës maqedone në Bernë).

2. Raporti vjetor i BISHZ-së prej 05.12.1998 deri më 10.12.1999

Dokumenti "Raporti vjetor i BISHZ-së prej 05.12.1998 deri më 10.12.1999 u është shpërndarë të pranishëmve.

Aprovimi i raportit të punës për periudhën dhjetor 1998 - dhjetor 1999

Në pjesën e parë dr. sc. Ahmet Xhigoli përmes folive paraqiti raportin e aktivitetit të BISHZ-së për periudhën dhjetor 1998 - dhjetor 1999. Në pjesën e dytë, zonja Florije Rexhaj paraqiti raportin financiar



për të njejtën periudhë, kurse në pjesën e tretë, zotëri Nazmi Jakurti paraqiti gjendjen e projektit BISHZ-BAG. Në vazhdim, në pjesën e katërt të kësaj pike, dr. Xhigoli dha gjendjen e tashme lidhur me nxjerrjen e revistës “Bashkimi“. Pastaj është debatuar lidhur me raportin dhe pjesët e tij. Në diskutime morrën pjesë: zotëri Ymer Cacaj, zonja Jollanda Parrucaj, zotëri Halim Hyda, zotëri Agim Mala, zotëri Shaip Beqiri, zotëri Skender Jusufi, zotëri Shaip Latifi, zotëri Afrim Rizvanolli, zotëri Sinollah Shehu. **Në përfundim të kësaj pike, raporti është aprovuar në tërësi.**

3. Zgjedhja e kryesisë së re sipas nenit 7.c. të Statutit

Në pikën e tretë të rendit të ditës janë dhënë disa rekomandime për zgjedhje. Pas përfundimit të diskutimeve me drejtë vote është vendosur, që Kryesia e re do të jetë në përbërje prej 9 anëtarëve.

Anëtarët e rinjë të zgjedhur në Kuvend janë: Nazmi Jakurti, Xhevat Salihu, Sinollah Shehu, Ismet Rexhaj, Ahmet Xhigoli, Lolita Poda, Arbër Ahmetaj, Fahri Mahalla, Abas Fejzullahi.

Njëzërit për Kryetar, Nënkyetar, Sekretar dhe Arkëtar janë zgjedhur:

- Kryetar: Nazmi Jakurti
- Nënkyetar: Xhevat Salihu
- Sekretar: Sinollah Shehu
- Arkëtar: Ismet Rexhaj

Zgjedhja e komisionit të kontroll-revizionit sipas nenit 7.d. të Statutit

Komisioni i revizionit përbëhet prej tre anëtarëve. Janë zgjedhur:

- Fahri Mahalla
- Lolita Poda
- Abas Fejzullahi

Zgjedhja e Komisionit Statutar

Komisioni Statutar përbëhet prej tre anëtarëve. Janë zgjedhur:

- Ahmet Xhigoli,
- Xhevat Salihu,
- Arbër Ahmetaj

Zgjedhja e Administarorëve

Për administrator të Shoqatës njëzëri janë zgjedhur:

- Adnan Mehmeti
- Shkumbin Rmoku
- Llokman Beqiri

Dr. Xhigoli në emër të Kryesisë i falendëroi anëtarët e kryesisë së vjetër dhe administartorët e Shoqatës për punën e tyre të mirë në periudhën 1997-1999.



4. Të ndryshme

- Është dhënë një pikë muzikore nga Grupi muzikor „Arbëria“ në Bernë
- Kryetari, dr. sc. Ahmet Xhigoli ndau tri mirënjohje. Dy për administratorët e BISHZ-së: Ismet Rexhaj dhe Adnam Mehmetit dhe një për Shoqërinë kulturore-artistike „Naim Frashëri“ në Bernë

Në fund të punimeve të Kuvendit të dytë të rregullt, Sekretariati i BISHZ-së, organizoi një koktej për të pranishmit.

Mbledhja e Kuvendit zgjati prej orës 14:00 deri në ora 17:00.

Udhëhqësi i protokolit: dr.sc. Ahmet Xhigoli

Bellach, 18 dhjetor 1999